

VENDIM
Nr. 64, datë 21.12.2022

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR RAPORTIMIN STATISTIKOR TË MJETEVE DHE DETYRIMEVE TË FONDEVE TË PENSIONIT”

Në bazë dhe për zbatim të nenit 43, shkronja “c”, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar; si dhe të ligjit nr. 30/2022, “Për miratimin e programit të statistikave zyrtare 2022–2026”, me propozimin e Departamentit të Statistikave Financiare, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Të miratojë rregulloren “Për raportimin statistikor të mjeteve dhe detyrimeve të fondeve të pensionit”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ngarkohet Departamenti i Statistikave Financiare të Bankës së Shqipërisë, për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

3. Ngarkohet Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve me publikimin e këtij vendimi, përkatësisht në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Gent Sejko

RREGULLORE
PËR RAPORTIMIN STATISTIKOR TË MJETEVE DHE DETYRIMEVE TË FONDEVE TË PENSIONIT

Neni 1

Objekti dhe fusha e veprimit

Rregullorja përcakton kërkesat e raportimit në lidhje me informacionin statistikor të mjeteve dhe detyrimeve të fondeve të pensionit që ushtrojnë aktivitet në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Neni 2

Baza ligjore

Kjo rregullore nxirret në mbështetje të:

- a) nenit 26, pika 1, të ligjit nr. 17/2018, “Për statistikat zyrtare”;
- b) ligjit nr. 30/2022, “Për miratimin e programit të statistikave zyrtare 2022–2026”.

Neni 3

Përcaktime

Për qëllime të kësaj rregulloreje:

- 1. “fond pensioni (FP) ka të njëjtin kuptim siç përcaktohet në nenin 5, pika 1, të ligjit nr. 10197, datë 10.12.2009, “Për fondet e pensionit vullnetar”.

Më poshtë nuk përfshihen në përkufizim:

a) “fondet e investimeve” (FI), siç përcaktohet në nenin 2, pika 23, të ligjit nr. 56/2020, datë 30.4.2020, “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive”,

b) “entitet me qëllim të posaçëm” (SPV) të përfshira në transaksionet e titullzimit, siç përcaktohet në nenin 4, pika 2, paragrafi 43, të rregullores nr. 48/2013 “Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit”,

c) “institucionet financiare monetare” (IMF), siç përcaktohet në nenin 3, pika 2, të rregullores nr. 73/2021 të Bankës së Shqipërisë “Mbi raportimet në Bankën e Shqipërisë të zërave të bilancit të institucioneve të kreditit dhe të institucioneve monetare financiare”,

d) “shoqëritë e sigurimit”, siç përcaktohet në nenin 4, pika 43, të ligjit nr. 52, datë 22.5.2014, “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”,

e) “fondet e pensioneve joautonome”, që janë fonde pensioni të cilat nuk janë njësi institucionale dhe mbeten pjesë e njësisë institucionale që i ka krijuar,

f) fondet e sigurimeve shoqërore përfshijnë njësitë institucionale qendrore dhe lokale aktiviteti kryesor i të cilave është të sigurojnë përfitime sociale dhe plotësojnë këto kritere:

- me ligj ose me rregullore, grupe të caktuara të popullsisë janë të detyruara të marrin pjesë në skema ose të paguajnë kontributet, dhe

- qeveria e përgjithshme është përgjegjëse për menaxhimin e institucionit në lidhje me zgjidhjen ose miratimin e kontributeve dhe përfitimeve, në mënyrë të pavarur nga roli i tij si organ mbikëqyrës ose punëdhënës;

2. “rezident” ka të njëjtin kuptim siç përcaktohet në nenin 3, pika 7, të rregullores nr. 73/2021 të Bankës së Shqipërisë “Mbi raportimet në Bankën e Shqipërisë të zërave të bilancit të institucioneve të kreditit dhe të institucioneve monetare financiare”;

3. “administrator” ka të njëjtin kuptim sipas përcaktimeve në nenin 4, shkronja “c”, të ligjit nr. 10197, datë 10.12.2009, “Për fondet e pensionit vullnetar”;

4. “të dhëna titull-për-titull” nënkupton të dhënat individuale për titujt;

5. “të dhëna zë-për-zë” nënkupton të dhënat e ndara në mjete ose detyrime individuale;

6. “të dhëna të përmbledhura” do të thotë të dhëna që nuk janë zbërthyer në mjete ose detyrime individuale;

7. “transaksion financiar” nënkupton një transaksion që rrjedh nga krijimi, likuidimi ose ndryshimi i pronësisë së mjeteve ose detyrimeve financiare, siç përshkruhet më tej në pjesën 5 të shtojcë II;

8. “ndryshime nga rivlerësimi” do të thotë ndryshime në vlerën e mjeteve dhe detyrimeve që rrjedhin nga ndryshimet në çmim /ose efekti i kursit të këmbimit të mjeteve dhe detyrimeve të shprehura në një monedhë të huaj, siç përshkruhet më tej në pjesën 5 të shtojcës II.

Neni 4

Popullata aktuale raportuese

1. Popullsia aktuale raportuese përbëhet nga shoqëritë administruese të fondeve të pensioneve të licencuara nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF).

2. Popullata aktuale raportuese do t'i nënshtrohet kërkesave të plota të raportimit statistikor.

Neni 5

Lista e fondeve të pensionit për qëllime statistikore

1. Banka e Shqipërisë (BSH) harton dhe përditëson listën e fondeve të pensionit (FP) që formojnë popullsinë aktuale raportuese, bazuar në informacionin statistikor të regjistruar nga AMF-ja.

2. BSH-ja publikon në faqen zyrtare të saj listën e përditësuar të FP-ve, dhe datën më të fundit të përditësimit.

Neni 6

Kërkesat e raportimit statistikor

1. Popullata raportuese raporton nëpërmjet AMF-së, në përputhje me marrëveshjen e bashkëpunimit ndërmjet dy institucioneve, informacionin e kërkuar në përputhje me shtojcat I dhe II, pjesë përbërëse dhe bashkëlidhur e kësaj rregulloreje:

a) me bazë tremujore, të dhënat e stokut tremujor mbi aktivet/pasivet e FP-ve dhe rregullimet tremujore të rivlerësimit ose transaksionet financiare në lidhje me aktivet/pasivet, kur është e aplikueshme;

b) me bazë vjetore, të dhënat e fundvitit për numrin e anëtarëve të fondeve të pensionit të ndara në anëtarë aktivë, anëtarë pasivë dhe anëtarë në pension.

2. BSH-ja përlogarit vlerësime tremujore për informacionin statistikor të FP-ve bazuar në të dhënat e ofruara në baza vjetore nga subjektet raportuese, në përputhje me nenin 6/1/b.

3. BSH-ja informon popullatën raportuese për qëllimet e ndryshme për të cilat janë mbledhur të dhënat e tyre.

4. Për të minimizuar barrën e raportimit të popullatës raportuese, BSH-ja do të kombinojë kërkesat e raportimit për qëllime të kësaj rregulloreje me të dhënat që mbledh AMF-ja.

Neni 7

Rregullimet e rivlerësimit dhe transaksionet financiare

1. Informacioni për ndryshimet nga rivlerësimi dhe transaksionet financiare do të merret si më poshtë:

a) popullata raportuese do të raportojë ndryshimet nga rivlerësimi ose transaksionet financiare, në përputhje me udhëzimet përkatëse të BSH-së, për informacionin e raportuar, sipas shtojca II dhe III;

b) BSH-ja do të nxjerrë përafrime të vlerës së transaksioneve të titujve nga të dhënat titull-për-titull ose do të mbledhë drejtpërdrejt të dhëna për transaksione të tilla nga popullata raportuese. BSH-ja mund të ndjekë gjithashtu një qasje të ngjashme për aktivet e tjera përveç titujve kur mbledhin të dhëna zë-për-zë;

c) në rastin e përfitimeve të pensioneve të dhëna nga FP-të, përafrimet e vlerës së transaksioneve financiare do të nxirren:

i. nga popullata raportuese, në përputhje me udhëzimet përkatëse të BSH-së në shtojcat bashkëlidhur kësaj rregulloreje,

ii. nga BSH-ja, bazuar në të dhënat e ofruara nga subjektet raportuese.

2. Udhëzime të mëtejshme në lidhje me hartimin e ndryshimeve nga rivlerësimi dhe transaksioneve financiare përcaktohen në shtojcën II, pjesa 4.

Neni 8

Parimet kontabël për qëllim të raportimit statistikor

1. Përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë rregullore, rregullat e kontabilitetit të ndjekura nga FP-të për qëllime të raportimit sipas kësaj rregulloreje do të jenë ato të përcaktuara në rregullat e kontabilitetit kombëtar dhe standardet ndërkombëtare përkatëse.

2. Fshirjet dhe zhvlerësimet e përcaktuara nga praktikat përkatëse të kontabilitetit do të përjashtohen nga shuma e principalit të papaguar të huave dhe do të raportohen veçmas.

3. Pa cenuar praktikat kontabël dhe marrëveshjet e netimit që mbizotërojnë në territorin e Shqipërisë, të gjitha aktivet dhe detyrimet financiare do të raportohen në bazë bruto për qëllime statistikore.

Neni 9

Afati i raportimit

1. Popullata raportuese raporton të dhënat e kërkuara tremujore, jo më vonë se 45 ditë pas fundit të periudhës së referencës.
2. Popullata raportuese raporton të dhënat e kërkuara vjetore, jo më vonë se 70 ditë pas periudhës së referencës.

Neni 10

Standardet minimale dhe rregullat kombëtare të raportimit

1. Popullata raportuese duhet të përmbushë kërkesat e raportimit statistikor të cilave u nënshtrohen, në përputhje me standardet minimale për transmetimin, saktësinë, përputhshmërinë me konceptet e përcaktuara në shtojcën III.
2. BSH-ja përkufizon dhe zbaton rregullat e raportimit që ndiqen nga popullata raportuese aktuale, në përputhje me kërkesat kombëtare. Këto rregulla të raportimit mundësojnë identifikimin e të dhënave të duhura statistikore dhe lejojnë që përmbushja e standardeve minimale rreth transmetimit të informacionit, saktësisë, përputhshmërisë me konceptet e përcaktuara në shtojcën III, të sigurohet në vijimësi.

Neni 11

Bashkimet me përthithje, ndarjet dhe riorganizimet

Në rast të një bashkimi me përthithje, ndarjeje ose riorganizimi që mund të ndikojë në përmbushjen e detyrimeve statistikore, çdo subjekt raportues i interesuar duhet të informojë AMF-në sapo të jetë publikuar synimi për të zbatuar një operacion të tillë dhe brenda një kohe të arsyeshme përpara se të hyjnë në fuqi procedurat që janë planifikuar për të përmbushur kërkesat e raportimit statistikor të përcaktuara në këtë rregullore.

Neni 12

Mbledhja e të dhënave

BSH-ja bashkëpunon me AMF-në për mbledhjen nga popullata raportuese të të dhënave të parashikuara në këtë rregullore, nëpërmjet lidhjes së një marrëveshjeje bashkëpunimi midis dy institucioneve.

Neni 13

Raportimi i parë

Raportimi i parë do të fillojë me të dhënat tremujore për tremujorin 4-t të vitit 2023 dhe të dhënat vjetore për vitin 2023.

Neni 14

Dispozitë e fundit

Shtojcat I, II dhe III bashkëlidhur kësaj rregulloreje janë pjesë përbërëse e saj.

KRYETAR I KËSHILLIT MBIKËQYRËS
Gent Sejko

SHTOJCA I
KËRKESAT PËR RAPORTIM STATISTIKOR

PJESA 1

KËRKESAT E PËRGJITHSHME TË RAPORTIMIT STATISTIKOR

1. Popullata aktuale raportuese duhet të sigurojë informacionin statistikor të mëposhtëm, në baza tremujore:

- a) të dhëna për titujt me kode ISIN;
- b) të dhënat për titujt pa kode ISIN, qoftë sipas raportimit titull-për-titull ose të përmbledhura, të ndara sipas kategorive të instrumentit, maturitetit dhe kundërpartisë;
- c) të dhëna për mjetet dhe detyrimet e ndryshme nga titujt, të ndara sipas kategorive të instrumentit, maturitetit dhe kundërpartisë.

2. Të dhënat e përmbledhura duhet të jepen në terma të stoqeve dhe, në përputhje me udhëzimet e BSH-së për sa i përket: a) rivlerësimeve për shkak të ndryshimeve të çmimeve dhe kursit të këmbimit; ose b) transaksionet financiare.

3. Standardi i raportimit për dhënat që duhet të jepen sipas formatit titull-për-titull specifikohen në tabelën 2. Kërkesat e agreguara të raportimit statistikor tremujor për stoqet dhe për rivlerësimet për shkak të ndryshimeve të çmimeve dhe kursit të këmbimit ose transaksioneve financiare, janë të specifikuara në tabelat 1a dhe 1b. Të dhënat vjetore që duhen dhënë në lidhje me numrin e anëtarëve të skemave pensionale janë të specifikuara në tabelën 3.

PJESA 2

Rezervat e fondit të pensionit

1. Sa i përket rezervave të fondit të pensionit, për kërkesat e raportimit të listuara më poshtë, subjektet raportuese duhet të kryejnë vlerësime nëse të dhënat nuk janë të disponueshme direkt, në përputhje me udhëzimet e përcaktuara nga BSH-ja dhe bazuar në praktikat më të mira evropiane:

- të drejtat e pensionit të ndara sipas skemave të kontributeve dhe përfitimeve të përcaktuara,
- ndryshimet nga rivlerësimi (përfshirë ndryshimet nga luhatja e kursit të këmbimit) ose transaksionet financiare për të gjitha ndarjet e kërkuara siç tregohet në tabelën 1b.

PJESA 3 TABELAT E RAPORTIMIT
TABELA 1A/B

Bilanci

Stoqet dhe ndryshimet nga rivleresimi (përfshirë ndryshimet nga kursi i këmbimit) ose transaksionet financiare

Tremujore

EMRI I FORMULARIT:		Pasqyra e detajuar e mjeteve dhe detyrimeve të Fondeve të Pensionit 1) 6)														
PERIODICITETI:		Tremujor														
MONEDHA E RAPORTIMIT:		Lekë														
LIVESIA:		Livësi monetare														

[illegible]

[illegible]

Shënime: 1) Të dhënat në tabelën 2 duhet të jenë të barabarta me të dhënat respektive të raportuara në bilanc (tabela 1).

2) Interesat e përlogaritur raportohen në instrumentin përkatës

3) Shpjegimet për sektorët i gjeninë faqen "Sektorët"

[Sektorët](#)

4) Tituj të borxhit dhe aksionet në këtë formular raportohen me vlerën e tregut.

5) Fonde të tregut të parasë - Fonde të tregut të parasë janë korporata financiare ose thuhet korporata, përveç bankës qendrore dhe institucioneve të kreditit, të cilat emetojnë kuota/aksione të fondeve të investimit që janë zëvendësues të përafërt të

6) Fonde të investimit **jo të tregut të parasë** - të cilat njihen edhe si fonde të përbashkëta ose institucione për investim kolektiv përfshin të gjitha skemat e investimeve kolektive të angazhuara në ndërmjetësim financiar. Aktiviteti i tyre është të emetojë

7) Pasqyra plotësohet vetëm në qelizat ku disponohet informacion.

	Nuk është i aplikueshëm (nuk vendoset vlerë)
	Formulë

Tabela 2
Të dhënat e titujve – databaza “titull për titull”

Kodi ISIN	Nr i ankandit	Emri i titullit të blerë nga sektori bankar	Tipi i instrumentit	Maturiteti	Listimi në bursë	Klasa e instrumentit	Data e emetimit	Data e blerjes	Data e maturimit	Emri i emetuesit	Sektori i emetuesit	Rezidenca e emetuesit	Kodi i vendit të emetuesit	Monedha	Transaksion (+/-) gjatë periudhës (në vlerë tregu)	Çmimi i blerjes	Vlera e tregut në fund të periudhës	Vlera kontabile në fund të periudhës	Interesi i përlogaritur në fund të periudhës

Tabela 3
Numri i anëtarëve të skemës së pensioneve
Vjetore

Numri i anëtarëve	Total	Nga të cilët: anëtarë aktivë	Nga të cilët: anëtarë pasivë	Nga të cilët: anëtarë në pension
-------------------	-------	------------------------------	------------------------------	----------------------------------

SHTOJCA II
PËRSHKRIME
PJESA 1
PËRSHKRIME TË KATEGORIVE TË INSTRUMENTEVE

1. Kjo tabelë ofron një përshkrim standard të detajuar të kategorive të instrumenteve. As lista e instrumenteve financiare individuale në tabelë dhe as përshkrimet e tyre përkatëse nuk synojnë të jenë shteruese. Përshkrimet i referohen Sistemit Evropian të Llogarive të krijuar nga rregullorja (BE) nr. 549/2013 (më tej “ESA 2010”).

2. Për disa nga kategoritë e instrumenteve kërkohen ndarje të maturitetit. Këto i referohen maturiteti original, pra maturimit në emetim, që është periudha fikse e jetës së një instrumenti financiar përpara së cilës ai nuk mund të blihet, p.sh. tituj të borxhit.

3. Detyrimet financiare mund të dallohen nëse janë të negociueshme apo jo. Një detyrim është i negociueshëm nëse pronësia e tij është lehtësisht e aftë të transferohet nga një njësi në tjetrën me dorëzim ose nënshkrim ose të kompensohet në rastin e derivateve financiare. Ndërkohë që çdo instrument financiar mund të tregtohet, instrumentet e negociueshme janë krijuar për t'u tregtuar në një bursë të organizuar ose “pa bursë”, megjithëse tregtimi aktual nuk është një kusht i domosdoshëm për negociueshmëri.

Tabela A
**Përshkrimi i kategorive të instrumenteve në aktivet
dhe detyrimet фондеве të pensionit
Mjetet**

Kategoritë e instrumenteve	Përshkrimi i instrumenteve
1. Monedha dhe depozita	Mbajtja e kartëmonedhave dhe monedhave në lek dhe valutë të huaj në qarkullim që përdoren zakonisht për të bërë pagesa dhe depozita të vendosura nga fondi i pensioneve (FP) pranë institucioneve financiare monetare (IFM). Ato mund të përfshijnë depozitat njëditore, depozitat me afat dhe depozitat me njoftim paraprak, si dhe marreveshjet e anasjella repo, ose borxhi i titujve kundrejt kolateralit në para (kjo zbatohet vetëm nëse pala tjetër është një korporatë depozituese (ESA 2010, paragrafi 5.130).
1.1. Depozita të transferueshme	Depozitat e transferueshme janë depozita të cilat janë drejtpërdrejt të transferueshme sipas kërkesës për të bërë pagesa tek agjentët e tjerë ekonomikë me mjete pagese të përdorura zakonisht, si transferimi i kredisë dhe debitimi direkt, mundësisht edhe me kartë krediti ose debiti, transaksione me para elektronike, çeqe ose mjete të ngjashme, pa vonesa, kufizime apo penalite të konsiderueshme. Depozitat që mund të përdoren vetëm për tërheqje parash dhe/ose depozita nga të cilat fondet mund të tërhiqen ose transferohen vetëm përmes një llogarie tjetër të të njëjtit pronar nuk duhet të përfshihen si depozita të transferueshme.
2. Tituj të borxhit	Zotërimet e titujve të borxhit, të cilat janë instrumente financiare të negociueshme që shërbejnë si dëshmi e borxhit, zakonisht tregtohen në tregjet dytësore. Ato gjithashtu mund të kompensohen në treg dhe nuk i japin mbajtësit asnjë të drejtë pronësie mbi institucionin emetues. Kjo kategori përfshin: — zotërimet e titujve të cilat i japin mbajtësit të drejtën e pakushtëzuar për një të ardhur fikse ose të përcaktuar me kontratë në formën e pagesave të kuponit dhe/ose një shumë fikse të deklaruar në një datë ose data specifike, ose duke filluar nga një datë e caktuar në koha e emetimit, — kreditë që janë bërë të tregtueshme në një treg të organizuar dytësor. Nëse nuk plotësohet ky kusht, ato duhet të klasifikohen në kategorinë 3 “Kredi” (shih gjithashtu “kredi të tregtueshme” në të gjitha kategoritë), — borxhi i varur në formën e titujve të borxhit (shih gjithashtu “borxhi i varur në pajisje e huave” në kategorinë 3 “Kredi”).
3. Huat	Për qëllime të kësaj forme raportimit, kjo kategori përbëhet nga fondet e dhëna hua nga FP për huamarrësit, ose hua të marra nga FP-të, të cilat ose janë të evidentuara nga dokumente të panegociueshme ose jo të evidentuara me dokumente. Kjo kategori përfshin zërat e mëposhtëm: — zotërimet e titujve të panegociueshëm: zotërimet e titujve të borxhit të cilat nuk janë të negociueshme dhe nuk mund të tregtohen në tregjet dytësore, — hua të tregtueshme: hua që de facto janë bërë të negociueshme klasifikohen në kategorinë “Hua”, që nuk ka dëshmi të tregtimit të tregut sekondar. Përndryshe ato klasifikohen si tituj borxhi (kategoria 2), — borxhi i varur në formën e huave: instrumentet e borxhit të varur sigurojnë një pretendim shtesë ndaj institucionit emetues që mund të ushtrohet vetëm pasi të jenë përmbushur të gjitha pretendimet me status më të lartë, duke u dhënë atyre disa nga karakteristikat e kapitalit. Për qëllime statistikore, borxhi i varur klasifikohet si “hua” ose “tituj borxhi” sipas natyrës së instrumentit. Kur zotërimet e një FP në të gjitha

	formave të borxhit të varur identifikohen si një shifër e vetme për qëllime statistikore, kjo shifër duhet të klasifikohet nën kategorinë tituj të borxhit, me arsyetimin se borxhi i varur është kryesisht në formën e titujve të borxhit. —pretendimet e marrëveshjeve të riblerjeve repo ose huamarrjen e titujve kundrejt kolateralit në para (kjo zbatohet vetëm nëse pala tjetër nuk është një korporatë depozituese (ESA 2010, paragrafi 5.130)): Kjo kategori përfshihet asetet në formën e depozitave të vendosura nga FP (të cilat përfshihen në kategorinë 1).
4. Kapitali	Mjetet financiare që përfaqësojnë të drejtat e pronësisë në korporata ose thuajse-korporata. Mjete të tilla financiare përgjithësisht u japin zotëruesve të drejtën për një pjesë në fitimet e korporatave ose kuazikorporatat, dhe për një pjesë në aktivet e tyre neto në rast likuidimi. Kjo kategori përfshin aksione të listuara dhe të palistuara dhe kapitale të tjera.
4.1. Aksione të listuara	Titujt të kapitalit të listuara në bursë. Bursa mund të jetë një bursë e njohur ose çdo formë tjetër e tregut dytësor. Aksionet e listuara quhen gjithashtu aksione të kuotuar.
4.2. Aksione të palistuara	Aksionet e palistuara janë tituj të kapitalit që nuk janë të listuara në bursë
4.3. Kapitale të tjera	Kapitali tjetër përfshin të gjitha format e kapitalit, përveç aksioneve të listuara dhe aksioneve të palistuara.
5. Kuotat e fondeve të investimit	Kjo kategori përfshin zotërimet e aksioneve ose njërive të emetuara nga fondet e tregut të parasë (FTP) dhe fondet e investimeve joFTP (d.m.th. fondet e investimeve të ndryshme nga FTP).
5.1. Aksionet e FTP	Zotërimet e aksioneve ose kuotave të emetuara nga FTP.
5.2. Aksionet e jo FTP	Zotërimet e aksioneve ose kuotave të emetuara nga fondet e investimeve (FI) të ndryshme nga FTP-të.
6. Rezervat e fondeve të pensionit	Kjo kategori përfshin: — pretendimet e PF-ve ndaj menaxherëve të pensioneve siç përkufizohen në ESA 2010, paragrafët 5.186 dhe 17.78, — pretendimet financiare të FP-ve ndaj korporatave të risigurimit të lidhura me rezervat e pensioneve (të rikuperueshmet nga risigurimi).
7. Derivatet financiare	Derivatët financiarë janë instrumente financiare të lidhura me një instrument financiar të caktuar, tregues ose mall, nëpërmjet të cilit rreziqet financiare specifike mund të tregtohen në tregjet financiare më vete. Kjo kategori përfshin: — opsionet, — garancitë, — kontratat e së ardhmes, — transfertat, — shkëmbimet, — derivativët e kredisë. Derivatët financiarë regjistrohen me vlerën e tregut në bilanc në bazë bruto. Kontratat individuale derivative me vlera pozitive tregu regjistrohen në anën e mjeteve të bilancit dhe kontratat me vlera negative të tregut në anën e detyrimeve të bilancit. Angazhimet bruto të ardhshme që rrjedhin nga kontratat derivative nuk duhet të futen si zëra në bilanc. Derivatët financiarë mund të regjistrohen në bazë neto sipas metodave të ndryshme të vlerësimit. Në rast se vetëm pozicionet neto janë të disponueshme, ose pozicionet regjistrohen ndryshe nga vlera e tregut, këto pozicione raportohen në vend të tyre.
8. Llogari të tjera të arkëtueshme/pagueshme	Ky është zëri i mbetur në anën e të tjerëve, që është aktiv në shoqërinë e “pasuri që nuk merr pjesë”. BSH-të mund të raportojnë e nën-pozicioneve të veçanta të përfshira në këto kategori, të tilla si: — dividendët e arkëtueshëm, — interesi i akumuluar i arkëtueshëm nga depozitat, — interesi i përlllogaritur i arkëtueshëm nga huat, — interesi i përlllogaritur i arkëtueshëm për titujt me vlerën e borxhit, — qiraja e përlllogaritur e arkëtueshme, — shumat e arkëtueshme të cilat nuk kanë të bëjnë me biznesin kryesor të FP.
9. Mjete të tjera jofinanciare	Mjete të qëndrueshme dhe të paqëndrueshme, të ndryshme nga mjetet financiare. Kjo kategori përfshin, ndërtesat dhe pajisjet e tjera, makineritë, produktet e pronësisë intelektuale si softuerët kompjuterikë dhe bazat e të dhënave.

Detyrimet

Kategoritë e instrumenteve	Përshkrimi i instrumenteve
10. Hua të marra	Shumat e borxhit ndaj kreditorëve nga FP, përveç atyre që dalin nga emetimi i titujve me vlerë të negociueshme. Kjo kategori përbëhet nga:

	— kreditë: huat e dhëna PF-ve të cilat ose janë të evidentuara me dokumente të panegociueshme ose të padëshmuara me dokumente, — marrëveshjet e riblerjes repo dhe tituj kundrejt kolateralit në para. — kolaterali në para i marre në këmbim të titujve të huazuar: — Kolaterali në para i marre në operacionet që përfshijnë transferimin e përkohshëm të arit kundrejt kolateralit.
11. Titujt të borxhit të emetuara	Tituj të emtuar nga FP, përveç kapitalit, që zakonisht janë instrumente të negociueshme dhe tregtohen në tregje dytësore, ose që mund të kompensohen në treg dhe nuk i japin mbajtësit asnjë të drejtë pronësie në lidhje me institucionin emetues.
12. Kapitali	Shiko kategorinë 4.
13. Rezervat teknike	Shuma e kapitalit që FP mban për të përmbushur kërkesat e ardhshme të pretendimeve të pensioneve të anëtarëve e tij.
13.1. Nga të cilat përfitimet e pensioneve	Shuma e kapitalit që FP mban për të përmbushur kërkesat e ardhshme për përfitimet të skemave të tij të pensioneve.
përfitimet e pensioneve, nga të cilat skema të përcaktuara kontributi	Shuma e që FP mban në mënyrë që të plotësojë kapitalin e tij të pensioneve të anëtarëve të saj. Në një skemë kontributesh të tjera, të ardhurat janë paguar nga performanca e mjeteve të fituara nga skema e pensioneve. Detyrimet i një skeme të përcaktuar kontributesh janë sa vlera e tregut të mjeteve të fondit.
Përfitimet e pensioneve, nga të cilat skema të përcaktuara përfitimi	Shuma e kapitalit që FP mban në mënyrë që të plotësojë kërkesat e ardhshme të pensioneve të anëtarëve të tij të skemës së përfitimeve të përcaktuara. Në një skemë pensioni me përfitime të përcaktuara, niveli i përfitimeve të pensioneve që u premtohen anëtarëve përcaktohet nga një formulë e rënë dakord paraprakisht. Detyrimi i një skeme pensioni me përfitime të përcaktuara është i barabartë me vlerën aktuale të përfitimeve të premtuara. <i>Skemat nocionale</i> të kontributeve të përcaktuara dhe <i>skemat hibride</i> grupohen si skema të përfitimeve të përcaktuara. Një skemë nocionale e kontributeve të përcaktuara është e ngjashme me një skemë kontributesh të përcaktuara, por me një shumë minimale të garantuar për t'u paguar. Skemat hibride janë ato skema të cilat kanë një element përfitimi të përcaktuar dhe një element kontributi të përcaktuar.
14. Pretendtimet e fondeve të pensionit për menaxheret e pensionit	Shiko kategorinë 6
15. Përfitimet për jopërfituesit e pensioneve	Kjo është tejkalimi i kontributeve neto mbi përfitimet, që paraqet një rritje të detyrimit të skemës së sigurimit ndaj përfituesve.
16. Derivatet financiare	Shiko kategorinë 7
17. Llogari të arketueshme/ pagueshme	Ky është zëri i mbetur në anën tjetër të bilancit, i përcaktuar si “detyrime të papërfshira diku tjetër”, të tilla si: — shumat e pagueshme që nuk lidhen me biznesin kryesor të FP-së, d.m.th. shumat që detyrohen furnitorëve, taksave, pagave, sociale etj. pensionet, dividendët etj., — pozicionet e neto që rrjedhin nga huadhënia e titujve me vlerën e pakolateralit në para, — shumat neto të pagueshme në lidhje me shlyerjet e tyre, të cilat kanë vlerë në titujt, — interesi i përlogaritur i pagueshëm për huat.
18. Net worth	Ky është zëri balancues i një bilanci.

PJESA 2

PËRSHKRIMET E ATRIBUTEVE TË RAPORTIMIT “TITULL PËR TITULL”

Tabela B

Kategoria	Përshkrimi
1. ISIN	Kodi ISIN përfaqëson një numër identifikues të veçantë për çdo titull
2. Emri i titullit	Emri i titullit përfaqëson emrin e titullit që raportohet, ashtu siç është specifikuar në kontratë.)
3. Tipi i instrumentit	Tipi i instrumentit përfaqëson tipin e titullit, si tituj kapitali-aksione më pak se 10%, obligacione dhe dëftesa, bono thesari, derivativë financiarë etj.
4. Listimi në bursë	Listimi në bursë tregon nëse titulli është e listuar apo jo në një treg të organizuar titujsh, bursë
5. Klasa e instrumentit	Klasa e instrumentit tregon nëse titulli është i tregtueshëm, e vendosjes apo e investimit.)
6. Data e emetimit	Data e emetimit përfaqëson datën kur instrumenti është emetuar për herë të parë.
7. Data e blerjes	Data e blerjes përfaqëson datën kur subjekti raportues ka blerë instrumentin
8. Data e maturimit	Data e maturimit përfaqëson datën kur instrumenti është maturuar

9. Emri emetuesit	i	Emri i emetuesit tregon emrin e subjektit që ka emetuar titullin
10. Sektori emetuesit	i	Sektori institucional sipas kategorive të përcaktuara në ESA.
11. Rezidenca emetuesit	e	Rezidenca e emetuesit tregon shtetin e rezidencës së subjektit që ka emetuar titullin.
12. Emri zotëruesit	i	Emri i zotëruesit tregon emrin e subjektit që zotëron titullin.
13. Sektori zotëruesit të titullit	i	Sektori institucional sipas kategorive të përcaktuara në ESA.
14. Monedha		Monedha tregon monedhën origjinale në të cilën titulli është emetuar dhe në të cilën shlyhet apo ripaguhet.
15. Transaksioni		Transaksioni gjatë periudhës tregon blerjen ose shitjen e titullit gjatë periudhës.
16. Vlera e tregut në fund të periudhës		Vlera e tregut në fund të periudhës përfaqëson vlerën e tregut të stokut të titullit në fund të periudhës.
17. Vlera kontabile në fund të periudhës		Vlera kontabile në fund të periudhës përfaqëson vlerën kontabile të stokut të titullit në fund të periudhës.
18. Interesi i përlogaritur në fund të periudhës	i	Interesi i përlogaritur në fund të periudhës përfaqëson interesin e përlogaritur për titujt e borxhit: obligacione dhe dëftesa, bono thesari etj.
19. Dividendi i paguar	i	Dividendi i paguar përfaqëson dividendin që paguhet për titujt të tipit “aksione më pak se 10% e kapitalit”.
20. Interesi i përlogaritur gjatë periudhës	i	Interesi i përlogaritur gjatë periudhës përfaqëson pjesën e interesit që përlogaritet vetëm për atë periudhë (fluksi). Kjo vlerë llogaritet si diferenca e stokeve të interesit të dy periudhave të njëpasnjëshme minus interesin e paguar. Vlera është gjithmonë pozitive dhe kërkohet për titujt e borxhit.
21. Interesi i paguar	i	Interesi i paguar përfaqëson interesin e paguar për titujt të borxhit: obligacione dhe dëftesa, bono thesari etj.

PJESA 3

Tabela C

Përshkrimi i anëtarëve të fondeve të pensionit

Kategoria	Përshkrimi
22. Numri i anëtarëve të skemave të pensionit	Numri i përgjithshëm i anëtarëve të skemave të pensionit. Kjo shumë është e barabartë me shumën e anëtarëve aktivë, anëtarëve pasive dhe anëtarëve në pension. Shihni kategoritë 2, 3 dhe 4.
23. Nga të cilët anëtarë aktivë	Numri i anëtarëve aktivë të skemës së pensioneve. Anëtar aktiv është një anëtar i skemës së pensioneve që jep kontribute (dhe/ose në emër të të cilit po bëhen kontributet) dhe po grumbullon mjete ose ka mjete të grumbulluara në të kaluarën dhe nuk është ende në pension.
24. Nga të cilët anëtarë pasivë	Numri i anëtarëve pasive të skemës së pensioneve. Një anëtar pasiv është një anëtar i skemës së pensioneve i cili nuk kontribuon më ose nuk grumbullon përfitime nga skema, por nuk ka filluar ende të marrë përfitime pensioni nga ajo skemë.
25. Nga të cilët anëtarë në pension	Numri i anëtarëve në pension të skemës së pensioneve. Një anëtar i pensionuar është një anëtar i skemës së pensioneve, i cili nuk kontribuon më ose nuk grumbullon përfitime nga skema dhe ka filluar të marrë përfitime pensioni nga kjo skemë.

PJESA 4

PËRSHKRIMET SIPAS SEKTORËVE

ESA 2010 ofron standardin për klasifikimin e sektoreve insitucionale. Tabela D jep një përshkrim të detajuar të sektorëve subjektet raportuese duhet të përdorin në klasifikimet e tyre kombëtare në përputhje me këtë rregullore. Kundërpartite rezidentë identifikohen sipas sektorit të tyre në përputhje me listat e publikuara nga BSH-ja dhe INSTAT-i për qëllime statistikore.

Tabela D

Sektori	Përshkrimi
1. <i>Qeveria qendrore</i>	Përfshin të gjitha departamentet administrative të shtetit dhe agjencitë qendrore kompetencat e të cilave shtrihen mbi të gjithë territorin ekonomik të vendit. Të tilla janë ministritë dhe administrata

	publike qendrore, organizatat jo me qëllim fitimi të kontrolluara nga qeveria
2. <i>Qeveria lokale</i>	përfshin bashkitë dhe pushtetin lokal. Të përfshira në këtë nënsektor janë gjithashtu, ato institucione jofitimprurëse, të cilat janë të kontrolluara nga pushteti vendor dhe që ushtrojnë aktivitetin e tyre vetëm brenda territorit ekonomik të qeverisë lokale.
3. <i>Fondet e sigurimeve shoqërore</i>	përfshin njësitë institucionale qendrore dhe lokale aktiviteti kryesor i të cilave është të sigurojë përfitime sociale dhe plotësojnë këto kritere: a) me ligj ose me rregullore, grupe të caktuara të popullsisë janë të detyruara të marrin pjesë në skema ose të paguajnë kontributet ; dhe b) qeveria e përgjithshme është përgjegjëse për menaxhimin e institucionit në lidhje me zgjidhjen ose miratimin e kontributeve dhe përfitimeve në mënyrë të pavarur nga roli i tij si organ mbikëqyrës ose punëdhënës.
4. <i>Banka qendrore</i>	funkcioni kryesor i saj është që të emetojë monedhën, të ruajë vlerën e brendshme dhe të jashtme të monedhës si dhe të mbajë të gjitha ose një pjesë të rezervave ndërkombëtare të vendit.
5. <i>Banka</i>	të gjitha subjektet që ushtrojnë veprimtari bankare në Republikën e Shqipërisë në bazë të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006, “Për bankat në Republikën e Shqipërisë.
6. <i>Shoqëritë e kursim kreditit</i>	janë institucione jo me qëllim fitimi, të cilat organizohen si bashkime vullnetare të personave juridikë ose fizikë. Ato mbledhin fonde nga anëtarët e tyre dhe u japin kredi vetëm anëtarëve të tyre. Veprimtaria e tyre rregullohet nga ligji “Për shoqëritë e kursim-kreditit” nr. 8782, datë 3.5.2001 dhe nga rregulloret e Bankës së Shqipërisë.
7. <i>Fondet e investimeve</i>	të cilat njihen edhe si fonde të përbashkëta ose institucione për investim kolektiv përfshin të gjitha skemat e investimeve kolektive të angazhuara në ndërmjetësim financiar. Aktiviteti i tyre është të emetojë aksione dhe kuota të fondeve të investimit, të cilat mund të jenë ose jo zëvendësues të afërt të depozitave, dhe bëjnë investime në mjete financiare afatshkurtra dhe afatgjata dhe në aktive jofinanciare (zakonisht në pasuri të patundshme). Në Shqipëri këto institucione operojnë në përputhje me ligjin nr. 10 198, datë 10.12.2009, “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive”. Shoqëritë administruese të fondeve të investimit nuk klasifikohen në këtë sektor, por klasifikohen si “Ndërmjetës të tjerë financiarë dhe ndihmësit financiarë”.
8. <i>Ndërmjetës të tjerë financiarë (përveç shoqërive të sigurimit dhe fondeve të pensionit vullnetar) dhe ndihmësit financiarë</i>	– përfshin të gjitha institucionet e tjera që kryejnë ndërmjetësim financiar apo lehtësojnë ndërmjetësimin financiar (përfshijë kompanitë e sigurimit dhe fondet e pensionit) të tillë si, institucionet e kreditit, institucionet që ofrojnë qiranë financiare (<i>leasing</i>), institucionet e financimit të transaksioneve tregtare, institucionet e mikrokreditit, faktoringut, të gjitha shërbimet e pagesave dhe transferimit të parave, unionet e Shoqërive të Kursim Kreditit, shoqëritë administruese të fondeve të investimit dhe të fondeve të pensionit vullnetar etj.
9. <i>Shoqëritë e sigurimit</i>	- ofrojnë shërbimet e sigurimit të jetës dhe jojetës për individë dhe kompani, si edhe risigurimin e kompanive të tjera të sigurimit. Këto kompani u sigurojnë përfitime financiare klientëve dhe personave të mbijetuar në raste aksidentesh, sëmundjesh, vdekjesh, katastrofash natyrore etj. Kompanitë e sigurimit financiar ose të sigurimit të kredisë sigurojnë mbulimin e riskut të humbjes financiare nga mos pagesat e ndryshme të kredisë etj.
10. <i>Fondet e pensionit vullnetar</i>	- përfshin të gjitha kompanitë, të cilat janë të angazhuara kryesisht në ndërmjetësim financiar si pasojë e grupimit të rreziqeve sociale dhe të nevojave të personave të siguruar. Fondet e pensioneve ashtu si skema e sigurimeve shoqërore, sigurojnë të ardhura pas daljes në pension dhe përfitime në raste paaftësie dhe vdekje. Në këtë nënsektor përfshihen vetëm fondet e pensioneve të cilat janë njësi institucionale të ndara nga kompanitë që i krijojnë ato. Të tilla fonde autonome kanë autonominë e vendimmarrjes dhe mbajnë një grup të plotë të llogarive, përfshirë bilancin kontabël. Pjesëmarrja në këto fonde është vullnetare dhe nuk përjashton detyrimin e personave për t'u siguruar sipas dispozitave ligjore në fuqi.
11. <i>Korporatat jofinanciare publike</i>	- janë korporata jofinanciare rezidente, thuajsekorporata dhe institucione jo me qëllim fitimi, të angazhuara në prodhim tregu, që kontrollohen dhe financohen kryesisht nga qeveria. Kontrolli mund të ushtrohet nga zotërimi i më tepër se gjysmës së të drejtave votuese ose nëpërmjet ligjit, me dekrete ose me rregullore, të cilat vendosin politikën nëpërmjet të cilës qeveria mund të emërojë drejtuesit. Këtu përjashtohen institucionet jo me qëllim fitimi, të cilat nuk angazhohen në prodhim tregu.
12. <i>Korporatat jofinanciare private</i>	– përfshijnë të gjitha njësitë institucionale, të cilat janë subjekte juridike të pavarura të krijuara me qëllim prodhimin e mallrave dhe shërbimeve jofinanciare për tregun dhe që nuk kontrollohen nga qeveria. Këtu përfshihen korporata jofinanciare rezidente, thuajsekorporata dhe institucione jo me qëllim fitimi të angazhuara në prodhimin e mallrave dhe shërbimeve për tregun. Thuajsekorporatat janë ndërmarrje joaksionere, të cilat funksionojnë si korporata. Që një thuajse korporatë të ekzistojë, ajo duhet të jetë e aftë të krijojë një plan të plotë llogarish, duke përfshirë bilancin kontabël, për të dalluar thuajsekorporatën nga pronarët e saj. Mjetet dhe detyrimet e lidhura me biznesin të thuajsekorporatës duhen ndarë nga mjetet dhe detyrimet e pronarëve. Gjithashtu, duhet të jetë i mundur identifikimi i flukseve të kapitalit dhe të të ardhurave që shkaktohen midis thuajsekorporatës dhe pronarëve të saj.

	Praktikisht, në nënsektorin e korporatave jofinanciare do të klasifikohen të gjitha shoqëritë tregtare private (jofinanciare) ose bizneset private të cilat ushtrojnë aktivitetin e tyre në përputhje me Ligjin nr. 9901 dt. 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”. Përjashtim bëjnë vetëm personat fizikë të cilët ushtrojnë aktivitetin e tyre në përputhje me nenin 1 të ligjit “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” dhe që do të klasifikohen në sektorin “Individët” (ekonomitë familjare).
13. Individët (ekonomitë familjare)	- përbëhet nga individë dhe grupe individësh, të cilët janë kryesisht konsumatorë. Ata ndajnë të njëjtën banesë, mbledhin një pjesë ose të gjitha të ardhurat dhe konsumojnë kolektivisht mallrat dhe shërbimet. Ky sektor përbëhet, gjithashtu, nga individë ose grupe individësh, të cilët janë sipërmarrës, pra janë të angazhuar edhe në aktivitet ekonomik, për shitje në treg ose për konsumin e vetë ekonomisë familjare, me kusht që prodhimi i mallrave dhe shërbimeve nuk realizohet nëpërmjet njësisë ekonomike të ndara të trajtuara si thuajse-korporata. Aktivitetet prodhuese të integruara në sektorin e ekonomive familjare, quhen ndërmarrje të patrupëzuara. Ato angazhohen në biznes nëpërmjet punës, kapitalit fizik dhe burimeve financiare të ekonomisë familjare. Gjithashtu, ato mund të marrin hua për të financuar aktivitetet prodhuese. Kapitali fizik dhe mjetet financiare të përdorura nga ndërmarrjet e patrupëzuara, i përkasin ekonomisë familjare, e cila është plotësisht përgjegjëse për huan dhe për detyrimet në lidhje me të. Ky biznes, nuk mund të angazhohet në transaksione me njësi të tjera për llogari të tij dhe nuk mund të zotërojë mjete apo të marrë përsipër detyrime në emër të tij. Sektori i ekonomive familjare përfshin: a) individë ose grupe anëtarësh funksioni kryesor i të cilëve është konsumi; b) personat që jetojnë në mënyrë të përhershme në institucione që kanë pak ose aspak autonominë e veprimit ose vendimit në çështjet ekonomike (p.sh. anëtarët e sekteve fetare që jetojnë në manastire, personat e moshuar që jetojnë në mënyrë të përhershme në shtëpitë e të moshuarve (azile) etj. c) individë ose grupe anëtarësh funksioni kryesor i të cilëve është konsumi dhe që prodhojnë mallra dhe shërbime për përdorim final ekskluzivisht vetjak; d) pronësitë personale dhe bashkëpronësitë pa status juridik (përveç atyre të cilat trajtohen si thuajse-korporata dhe të cilat janë prodhues tregu). Të tillë do të konsiderohen personat fizikë të cilët kryejnë aktivitet tregtar në përputhje me nenin 1, ligji nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare. e) institucionet jofitimprurëse që i shërbejnë ekonomive familjare, të cilat nuk kanë status të pavarur juridik.
14. Institucionet jo me qëllim fitimi në shërbim të individëve	- përfshin institucionet jo me qëllim fitimi të cilat janë njësi ligjore të pavarura, u shërbejnë ekonomive familjare dhe janë prodhues privat që nuk prodhojnë për tregun. Institucionet jo me qëllim fitimi, të angazhuar në prodhim, por jo për tregun, i sigurojnë ekonomive familjare mallra dhe shërbime falas, ose me çmime që nuk janë ekonomikisht domethënëse. Ato financohen kryesisht nga kontributet vullnetare, nga kuotat e anëtarëve, pagesat e bëra nga qeveria e përgjithshme apo nga fitimet që rrjedhin nga mbajtja e mjeteve financiare ose jofinanciare. Llojet kryesore të institucioneve jo me qëllim fitimi në shërbim të ekonomive familjare janë: a) sindikatat, shoqatat profesionale, shoqatat e konsumatorëve, partitë politike, kisha apo shoqëritë fetare (duke përfshirë edhe ato të financuara, por jo të kontrolluara nga qeveria) dhe klubet sociale, kulturore, sportive etj.; dhe b) organizatat bamirëse, mbështetëse dhe të ndihmës, të financuara nga transfertat vullnetare në para (cash) ose në natyrë nga njësi të tjera institucionale. Institucionet jo me qëllim fitimi në shërbim të ekonomive familjare jo për tregun, të kontrolluara nga qeveria e përgjithshme klasifikohen në sektorin e qeverisë. Institucionet jo me qëllim fitimi, të cilat janë nën kontrollin e qeverisë klasifikohen në sektorin e qeverisë që i kontrollon ato.

PJESA 5

PËRSHKRIMET E TRANSAKSIONEVE FINANCIARE DHE NDRYSHIMET NGA RIVLERËSIMI

1. “Transaksionet financiare” u referohen atyre transaksioneve që lindin nga krijimi, likuidimi ose ndryshimi i pronësisë së mjeteve ose detyrimeve financiare. Këto transaksione përlogariten si diferencë midis pozicioneve stok të periudhës së referencës, nga të cilat zbriten efektet e ndryshimeve që rezultojnë “Rivlerësimi” (si pasojë e ndryshimeve të çmimeve dhe kursit të këmbimit) dhe “riklasifikimeve të tjera”. Banka e Shqipërisë kërkon informacion statistikor me qëllim të përpilimit të të dhënave për transaksionet financiare në formën e ndryshimeve që përfshijnë “riklasifikime dhe ndryshimeve të tjera”, si dhe “rivlerësimet të çmimeve dhe kursit të këmbimit”.

2. “Ndryshimet e rivlerësimit” u referohen ndryshimeve në vlerësimin e mjeteve dhe detyrimeve që rrjedhin nga ndryshimet në çmimin e mjeteve dhe detyrimeve dhe/ose efekti i kursit të këmbimit të mjeteve dhe detyrimeve të shprehura në monedhe e huaj. Rivlerësimet e çmimeve përfshijnë ndryshimet që ndodhin me kalimin e kohës në vlerën e stoqeve në ditën e fundit të periudhës së referencës, për shkak të ndryshimeve në vlerën e referencës në të cilën ato regjistrohen, d.m.th. fitimet/humbjet e mbajtjes. Lëvizjet në kurset e këmbimit kundrejt monedhës vendëse (lek) që ndodhin ndërmjet datave të raportimit në fund të periudhës sjellin ndryshime në vlerën e mjeteve/detyrimeve në valutë të huaj kur shprehen në lek. Duke qenë se këto ndryshime përfaqësojnë fitime/humbje të mbajtjes dhe nuk janë pasoje e transaksioneve financiare, *këto efekte duhet të hiqen nga të dhënat e transaksioneve.*

3. “Zhvlerësimet/fshirjet” u referohen uljes së vlerës së një kredie të regjistruar në bilanc, ku kredia konsiderohet të jetë një aktiv pa vlerë (zhvlerësim) ose kur mendohet se kredia do të mos rikuperohet plotësisht (fshirje). Përfshihen gjithashtu zhvlerësimet/fshirjet e njohura në momentin kur një kredi shitet ose transferohet te një palë e tretë, aty ku janë të identifikueshme.

SHTOJCA III

STANDARDET MINIMALE QË DUHET TË PËRMBUSHË POPULLATA E SUBJEKTEVE RAPORTUESE

Subjektet raportuese duhet të përmbushin standardet minimale të mëposhtme për të përmbushur kërkesat e raportimit statistikor të Bankës së Shqipërisë.

1. Standardet minimale për tejçimin/ përcjelljen e informacionit:

- a) raportimi duhet të jetë në kohë dhe brenda afateve të përcaktuara nga Banka;
- b) raportet statistikore duhet të jenë në përputhje me formën dhe formatin e tyre nga kërkesat e raportimit teknik të përcaktuara nga Banka;
- c) subjekti raportues duhet t’i japë Bankës të dhënat e një ose më shumë personave kontaktues;
- d) duhet të ndiqen specifikimet teknike për transmetimin e të dhënave në Bankën e Shqipërisë.

2. Standardet minimale për saktësinë:

a) informacioni statistikor duhet të jetë i saktë: të gjitha kufizimet paralele/ rregullat e kontrollit duhet të përmbushen (p.sh. mjetet dhe detyrimet duhet të balancohen, nëntoale duhet të mblidhen në total) dhe të dhënat duhet të jenë të qëndrueshme në të gjitha frekuencat e raportimit;

b) subjektet raportuese duhet të jenë në gjendje të japin informacion mbi zhvillimet që tregojnë të dhënat e dërguara;

c) informacioni statistikor duhet të jetë i plotë dhe nuk duhet të përmbajë boshllëqe të vazhdueshme dhe strukturore. Mangësitë ekzistuese duhet të njihen, t’i shpjegohen Bankës qendrore dhe, kur është e aplikueshme, të kapërcehen sa më shpejt që të jetë e mundur;

d) subjektet raportuese duhet të ndjekin dimensionet, politikën e rrumbullakosjes dhe numrat dhjetorë të vendosur nga Bankat për përcjelljen teknike të të dhënave.

3. Standardet minimale për përputhshmërinë me konceptet:

a) informacioni statistikor duhet të jetë në përputhje me përkufizimet dhe klasifikimet e përfshira në këtë rregullore;

b) në rast të devijimeve nga këto përkufizime dhe klasifikime, subjektet raportuese duhet të monitorojnë dhe të përcaktojnë në mënyrë të rregullt diferencën ndërmjet metodologjisë së përdorur dhe asaj që përcakton kjo rregullore;

c) subjektet raportuese duhet të jenë në gjendje të shpjegojnë ndryshimet/ thyerjet në të dhënat e përcjella më parë/ transmetuara krahasuar me shifrat e periudhave të mëparshme.

4. Standardet minimale për rishikime: duhet të ndiqen politikat dhe procedurat e rishikimeve të përcaktuara nga Banka e Shqipërisë. Rishikimet që devijojnë nga rishikimet e rregullta duhet të shoqërohen me shënime shpjeguese të detajuara.